



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 6114/1 Prot.

Tiranë, më 23/11/2022

URDHËR

Nr. 622, Datë 23. 11. 2022

**“PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,  
NOTERES [REDAKTUAR]”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “b”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

**KONSTATOJ:**

Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar në nenin 21, gërma “b”, parashikon heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit përmes Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri mbush moshën 70 vjeç.

Nga verifikimet e kryera nga Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, rezulton se noterja [REDAKTUAR] është e ditëlindjes 25.09.1952, si rrjedhojë ndodhemi në kushtet e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën “b” të nenit 21 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” i ndryshuar, ku parashikohet se “*Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri: ...b) mbush moshën 70 vjeç...*”

Sa më sipër, në respektim të parashikimeve të akteve Ligjore e nënligjore në fuqi për noterinë, dhe në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, nenit 7 pikës 2, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “b”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

**URDHËROJ:**

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit noteres [REDAKTUAR] anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë, për shkak të mbushjes së moshës 70 vjeç.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
  - a) Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
  - b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë;
  - c) Një noter i caktuar nga Dhoma e Kombëtare e Noterisë.

3. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterës [REDAKTUAR] nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.

4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e Linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit, të Parave, Bankat e nivelit të dytë;

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivore, nëse ka të tilla.

6. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dëjani e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit, të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë.

8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë për njoftimin e këtij Urdhri noterës [REDAKTUAR], Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Tiranë.

12. Ngarkohet Drejtoria FIK në Ministrinë e Drejtësisë për të çaktivizuar ish-noteren, si përdoruese të sistemit RNSH, si dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë nga sistemi NISA.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

